



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 428/Prot  
01.09.02.22



Nr. 106/1 prot.

Shkoder, më 1.02.2022

**Lënda:** Mbi vendimin nr. 7, datë 26.01.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**


Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, gërma a, neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, të VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 420 prot., datë 01.02.2022 “Dokumentacioni shoqërues i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës të datës 26.01.2022”, shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 7, datë 26.01.2022 “Për antenë radiofonike dhe televizive”, në ekonominë pyjore Bushat Bërdicë, ngastra 14/a, me sipërfaqe 0.0205 ha.*

Për sa më sipër, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 04, datë 26 .01 .2022

PËR ANTENË RADIOFONIK DHE TELEVIZIV

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "e1", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 25 pika 1, e ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet" ,pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016,i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" ,si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" *me shumicë të cilësuar votash.*

V E N D O S I

1. Miratimin e antenës radiofonik dhe televiziv,në ngastres nr .14/a ekonomia pyjore Bushat Berdice me sipërfaqe 0.0205 ha
2. Afati i dhënies me qera të jetë 5 vjeçar.
3. Efektet: Jep impakt të pozitive tek komuniteti duke rigjeneruar te ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM, Nr. 1064, dt. 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".
5. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**K R Y E T A R**  
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 31 .01 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT  
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 86 prot.

Vau Dejës, më 31.12.2021

## RELACION

### PËR ANTENË RADIOFONIKE DHE TELEVIZIVE

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkia **Vau i Dejes**, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31 118.2 ha ha. Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qera/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.

Kështu kompania "**Towers Network Albania**", me kerkese me nr 5753 prot datë 20.10.2021, administruar pranë Bashkisë Vau i Dejës , kërkon përdorimin e fondit pyjor/kullosor **për antenë radiofonike dhe televizive** e ndodhur në Zefjanë,Njësia Administrative Bushat ekonomia pyjore bushat bërðice.

Kjo sipërfaqe është përdorur nga subjekti **Plus Communicotion sh.a** sipas kontrates se qirase me ish komunën Bushat me nr 815/1 prot dt 02.08.2010 me afat 9 vjeçar e cila ka nënshkruar një marrëveshje me subjektin "**Towers Network Albania**"për transferimin e veprimtarisë ekonomike të degës së ndermarrjes nr .1793 REP dhe 467/1kol dt 20.05.2016.

Kontrata e qirasë ( përdorimit) për sipërfaqen pyjore në fshatin Bushat ndodhet në Ekonominë Pyjore Bushat Bërðice, Njësia administrative Bushat.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar pranë Bashkisë Vau i Dejës/ Sektorit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave , rezulton që parcela në të cilën është e ndërtuar kjo antenë komunikimi , është pjesë e inventarit të pronave të Bashkisë Vau i Dejës , kjo bazuar në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive", me nr Ngastre 14/a dhe bën pjesë në ekonomine pyjore **Bushat Bërðice**,sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **16**.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,neni 9 pika 1.2 c , nenin 27 pika 5,neni 54 pika e1 , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë ,tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 22/g , përjashton nga konkurimi publik dhënien në përdorim të sipërfaqeve për ndertimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Towers Network Albania” është konform pikës 22 g të këtij Udhëzimi,pikes 24 dhe përbëhet nga:

- a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) kontratat ekzistuese të lidhura me autoritetet përkatëse ( ish Komuna Bushat)
- c) projektin teknik të zbatimit
- d) hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10 000 ku janë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastralë pyjorë dhe kullorë;
- e) lejen e mjedisit
- f) lejen e ndërtimit;
- g) aktin e regjistrimit pranë QKR-së.

Bazuar në ligjin nr 57/2020 dt 30.04.2020 “Për pyjet neni 25 , VKM nr. 1064 date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391/2006 “ Për tarifën në shërbimin pyjor/kullor i ndryshuar , lidhja 2 pikat 7 :5 dhe 12:5 në bazë të “përdorimit të territorit” dhe afatit të dhënies në përdorim janë përcaktuar tarifën si më poshtë:

7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur ne ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
			1-5 vjet	6-10 vjet
5	Toke djerre	0.0205	6 500 000	5 500 000

Ne funksion te sipërfaqes që merret në përdorim, subjekti ka servitut edhe përdorimin e rrugës, Bushat - Zefjane ,të cilat sipas VKM 1064, Lidhja 2, Pikat 12;5 , Tarifohen si më poshte:

12. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues			
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në km	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit
5	Toke djerre	0.311	30 000

**Në total: 142 580 (Njeqind e dyzet e dy mije e peseqind e tetedhjetë) lekë.**

Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, është përgatitur raport studimi tekniko ekonomik për këto sipërfaqe si edhe tabelat shoqëruese sipas modelit të miratuar në udhëzimin nr 1 të Ministrisë të Mjedisit, me të dhënat kryesore të sipërfaqes objekt përdorimi , hartat topografike me koordinatat , kufijtë si edhe përdorimin e territorit.

Bazuar në sa më sipër propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera për një afat **5(pesë) vjekar**,për shfrytëzimin e sipërfaqes djerre sipas të dhënave të sipërcituara.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit

**Specialistet**

**Ing. Mark Suli**



**Ing. Zeqir Ujka**



**Miratoi**

**Drejtori**

**Rrok ftoni**





**R A P O R T**

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE  
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI  
PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS**

**PËR ANTENË RADIOFONIKE DHE TELEVIZIVE**

Bazuar në Urdhërin nr.16 datë 19.01.2021 të kryetarit të bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore objekt, dhenje me qira te fondit pyjor për antenë radiofonik dhe televiziv, grupi i punës i përbërë nga, Z.Zeqir Ujka, pergjegjes sektori Z.Mark Suli specialist i Menaxhimit të pyjeve, Esmeraldo Harapi specialist, i cili nga data **28.12.2021** deri në datën **31.12.2021**, studioj kërkesën e subjektit (shoqërisë) **“Towers Network Albania”sh.p.k** dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objekt i dhënies në përdorim për antenë radiofonike dhe televizive.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 0.0205 ha, dhe bën pjese në **ngastrën nr.14/a** në ekonomine pyjore **Bushat Bërdice**, sipas listes së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **16** dhe është në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës. Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse 1 dhe 2 Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga **Shoqëria “Towers Network Albania”**, nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve, në **ngastrën nr.14/a, ekonominë Pyjore Bushat Bërdice**, por jepen në përdorim në një afat **5 vjeçar**.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim të sipërfaqeve nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar

“Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 9.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kollusor publik”,pika 22 germa g.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë **Vau Dejës** dhe likujdimit të tarifës prej 142 580 (Njeqind e dyzet e dy mijë e peseqind e tetedhjetë) lekë. Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve në 1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”,si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

**a) Vlerën e përdorimit lek/ha/vit**

Trungishte \_\_\_\_\_ ha x \_\_\_\_\_ lek = \_\_\_\_\_ lekë  
Cungishte \_\_\_\_\_ ha x \_\_\_\_\_ lek = \_\_\_\_\_ lekë  
Shkurre \_\_\_\_\_ ha x \_\_\_\_\_ lek = \_\_\_\_\_ lekë  
Toke djerre. ha 0.0205 x 6 500 000 leke/ha/vit = **133 250** lekë

**a/2) Vlera e përdorimit të rrugës auto në km**

Trungishte \_\_\_\_\_ km x \_\_\_\_\_ lek = \_\_\_\_\_ lekë  
Cungishte \_\_\_\_\_ km x \_\_\_\_\_ lek = \_\_\_\_\_ lekë  
Shkurre \_\_\_\_\_ km x \_\_\_\_\_ lek = \_\_\_\_\_ lekë  
Toke djerre.0.311 km rruge auoto x 30 000 leke/km/vit = **9330** lekë

**Në total: 142 580 (Njeqind e dyzete e dy mijë e peseqind e tetedhjetë) lekë ne vit.**

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing.Mark Suli



Ing.Zeqir Ujka



**KRYETARI  
MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/KRYETAR  
LESTINË NDOJA**



Bashkia Vau Dejës

**PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (sipas regjistrit kadastral)**

ID.	Ekon.Pyjore	Parc	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Mosha K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore	
							D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	Total
Sh160014/a	Bushat Berdice	14a	Djerre		0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsejt</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Bashkia Vau Dejës

**PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas verifikimit ne terren)**

Formulari 1

ID.	Ekon.Pyjore	Parc	Perb. grumb	Funksioni	Forma Qeverisjes	Mosha K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore	
							D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Katet	Total
Sh160014/a	Bushat Berdice	14/a	Djerre		0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsejt</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>												

**PLOTESOI:**

Ing. Mark Suli

Ing. Zeqir Ujka




**Bashkia Vau Dejës**

**TABELA PERMBLEDHËSE E VLERESIMIT FINANCIAR**

**Per antene radiofonike dhe televizive**

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m <sup>3</sup> sipas asortimenteve	Volumi ne m <sup>3</sup> /kv/k	Dhenje ne perdorim lek/ha/vit		Vlera lek m <sup>3</sup>	Shuma I	Gjatesia e perdorimit ne km	Tarifa dhenje ne perdorim lek/km/vit				Shuma II	Totali I+II
					Ha	leke				1	2.-5	6.-10	11		
0	1	2	3				4	5	6	7	8	9	10	11	12
Trungishte	0	Vau Dejës	L. punimi	0	0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
			Dru zjarri	0	0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
Cungishte	0			0	0	0	0	0	0	Tubacion	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
Shkurre	0			0	0	0	0	0	0	Tubacion	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
Kullote	0	Vau Dejës		0	0	0	0	0	0	Tubacion	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Tubacion	0	0	0	0	0
Bimsi djerr	0.0205	Vau Dejës		0	0	0	0	0	0.311	Rruge	9330	0	0	9330	9330
				0	0	0.0205	133 250	0	0	0	0	0	0	0	133 250
Inprodukti ve	0	Vau Dejës		0	0	0	0	0	0	Tubacion	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Rruge	0	0	0	0	0
				0	0	0	0	0	0	Linje	0	0	0	0	0
Bime med	0			0	0	0	0	0	0	Tubacion	0	0	0	0	0
Gjuetia	0		Lepur, Thell.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Invest	0	Vau Dejës		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsejt</b>				0	0	0.0205	133 250	0	0	0	0	0	0	0	142 580


**PLOTESOI:**

Ing. Mark Suli  


Ing. Zeqir Ujka  




# Ekonomia Pyjore Bushat-Berdice SH 1:10 000



Nr	Koordinatat, sistemi Alb. 1986	
	X	Y
1	4378072	4648937
2	4378085	4648945
3	4378079	4648956
4	4378065	4648948

Parcela	Ngastra	Siperfaqja (m <sup>2</sup> )
S	14a	205

*[Handwritten signature]*



Nr. 815/ Prot.

8

Bushat, 02.08.2010

## KONTRATE QIRAJE

Sot me date 02.08.2010, palët si me poshtë me vullnetin e tyre te lire dhe te plote redaktuan Kontratën e Qirasë si vijon:

KOMUNA BUSHAT, këtu e referuar me poshtë "Qiradhënësi" e përfaqësuar ligjërisht nga Z. ZEF HILA me detyre Kryetar i Komunës Bushat.

dhe

**PLUS COMMUNICATION Sh.A.** shoqëri aksionare e së drejtës shqiptare, regjistruar si person juridik me nr. NIPT K91811014B, datë 11.06.2009 me seli ne Tirane, përfaqësuar nga Administratori Z. Petraq Shomo dtl. 07.01.1963, lindur dhe banues ne Tirane, i cili përfaqësohet ligjërisht nga Z. Gentian Hasibra i biri i Hazizit dtl. 13.10.1976, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID nr. 024430049, në bazë të Prokurës së Posaçme nr. 162 Rep., Nr. 83 Kol, datë 20.01.2010, (këtu e më poshtë referuar si "Qiramarrësi" ose "Shoqëria"),

### Baza Ligjore:

Ligji Nr. 8652, date 31.07.2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar me Ligjin nr. 9208 date 18.03.2004, neni 8 Kreu 6 pika a, neni 32 pika e, Neni 80/1 e ne vijim i Ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994 "Për Kodin Civil te Republikës se Shqipërisë", Vendimi i Këshillit te Komunës Bushat nr: 23 date 17.06.2010, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr: 1184/1 Prot, date 6.7.2010.

### Neni 1

#### Përcaktime

Stacion: Vendi ne te cilën do te instalohet një Stacion Baze Transmetimi dhe/ose "Pajisjet e Jashtme", qe do te përbëhet kryesisht, por jo vetëm, nga një kontejner, një Antene dhe aksesoret e saj, një Gjenerator si dhe çdo pajisje apo material tjetër te nevojshëm për funksionimin e Stacionit. Ky Stacion ndërtohet nga Qiramarrësi për qëllimin e ushtrimit te aktivitetit te tij dhe është ne pronësinë e Qiramarrësit.

Rruge Kalimi: Rruga për ne Stacion përfshin kalimin nga Rruga kryesore deri tek Stacioni, e cila është pjese e fondit bashkiak, e administruar nga Qiradhënësi dhe i shërben Qiramarrësit si pjese funksionale për te hyre ne stacion e ndërtuar prej tij.

### Neni 2

#### Objekti i Kontratës

Qiradhënësi deklaron se është pronar i ligjshëm i pasurisë se paluajtshme, me numër pasurie 377/6, vol: 8, fq: 203, ZK: 1329, te ndodhur ne Bushat, pronësia mbi te cilën është fituar ne baze te VKM Nr. 68, datë 28.1.2008 dhe VKM nr: 1061 date 16.7.2008, siç edhe rezulton nga dokumentet bashkëngjitur kësaj kontrate (këtu e më poshtë referuar si "Prona").

Qiradhënësi i jep me qira Qiramarrësit sipërfaqen prej 300 (treqind) metër katror (m<sup>2</sup>) me numër pasurie 377/6, vol: 8, fq: 203, ZK: 1329, te ndodhur ne Bushat, ne administrim nga Komuna Bushat dhe



do te përdoret nga Qiramarrësi dhe/ose nenkontraktoret e tij për te vendosur/implementuar Aparatet Marrëse-Dhënëse GSM/UMTS dhe pjesët e tyre te cilat do te përdoren nga shoqëria PLUS COMMUNICATION Sh.A. për ofrimin e shërbimeve te saj qe do te përfshijë, por nuk do te kufizohet vetëm te aparatet, antena, kulla, kablllo, tela, gjeneratorë por edhe ne pajisje ndihmese, pajisje për energjinë elektrike, bateri, kontejnerë, skara metalike, shirita togëzues, pllaka metalike dhe pajisje te tjera te nevojshme dhe qe kane lidhje me implementimin dhe funksionimin e Aparateve Marrëse-Dhënëse GSM/UMTS dhe pjesëve te tyre.

Ne rast se rruga është ekzistuese, atëherë Qiramarrësi lejohet te kryje punime sipas legjislacionit përkatës për përmirësimin dhe përshtatjen e rrugës ne mënyrë qe te jete e kalueshme për mjetet e Qiramarrësit.

Vendndodhja e stacionit qe do te ndërtohet nga Qiramarrësi dhe rruga tregohen ne hartën bashkëngjitur kësaj kontrate.

### Neni 3

#### Qëllimi

Kjo kontrate ka për qëllim dhënien ne përdorim te sipërfaqes se përcaktuar ne nenin 2 te kësaj kontrate për ndërtimin e një stacioni nga Qiramarrësi, kundrejt pagesës se qirasë, sipas qëllimit dhe kërkesave te përcaktuara ne kontrate.

### Neni 4

#### Afati i kontratës

- 4.1 Kontrata e Qirasë lidhet për një afat 9 (nëntë) vjeçar, duke filluar nga data 02.08.2010 deri me 02.08.2019.
- 4.2 Kjo kontrate me përfundimin e saj mund te rinovohet duke qene Qiramarrësi i preferuar ne marrje me qira te saj. Gjashte (6) muaj përpara përfundimit te afatit te mësipërm, secila Pale duhet te njoftoje palën tjetër për te negociuar shtyrjen e afatit te kontratës për te njëjtën periudhe ose për përfundimin e saj.
- 4.3 Ne mungese te këtij njoftimi ose te ndonjë komunikimi midis palëve, kontrata do te rinovohet automatikisht për te njëjtën periudhe dhe me te njëjtat kushte .

### Neni 5


#### Vlera e qirasë

- 5.1 Vlera e qirasë vjetore për ngritjen e stacionit për sipërfaqen e dhënë me qira, sipas përcaktimeve te bëra ne nenin 2 te kësaj kontrate, VKM 68 date 28.01.2008 dhe VKM 391 date 21.06.06 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", është 225.000 Leke (dyqind e njëzetë e pese mijë Leke).

### Neni 6

#### Pagesa dhe regjimi i saj

- 6.1 Pagesa do të bëhet në dy pjesë, një në çdo 6 muaj të vitit në shumën 112.500 Leke (njëqind e dymbëdhjetë mije e pesëqind Leke) secila. Pagesa e pare do te behet brenda 30 (tridhete) ditëve pune nga nënshkrimi i Kontratës nga Palët por gjithmonë pas lëshimit te Faturës Tatimore përkatëse ose Faturës për Arkëtim sipas modelit te miratuar me Udhëzimit nr: 19 date 20.05.2010 nga Ministria e Financave.
- 6.2 Pagesa ne vijim pas pagesës se pare do të bëhet brenda 15 ditëve pune që nga dita e fundit e përfundimit të 6 mujorit të fundit (të mëparshëm).



- 6.3 Për çdo pagese, Qiradhënësi do të lëshojë paraprakisht Faturën Tatimore përkatëse ose Faturën për Arkëtim sipas modelit të miratuar me Udhëzimit nr: 19 date 20.05.2010 nga Ministria e Financave.
- 6.4 Në rast se PLUS COMMUNICATION Sh.A. nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura në pikën 6.1 të mesipërme, palet do të kenë të drejtë të perfitojnë një kamat vonese prej 0.01 % për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10 % e vlerës totale të pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatvonesave do të konsiderohet data në të cilën PLUS COMMUNICATION SH.A. do të urdherojë kalimin në llogari të shumës së qirase.
- 6.5 Në çdo rast qiradhënësi nuk do të kërkojë në asnjë mënyrë përgjatë afatit kohor të kësaj kontrate ndryshimin e çmimit të qerasë.
- 6.6 Qiraja do të paguhet pas lëshimit të faturës së lartpërmendur, në llogarinë Bankare të Qiradhënësit:

Emër, Mbiemër: Komuna Bushat  
Llogaria Bankare numër:  
I.B.A.N:  
Banka:  
Monedha LEK

#### Neni 7 Të drejta dhe detyrimet e Qiradhënësit

##### Qiradhënësi:

- 7.1 Do të sigurojë gëzimin e lirë dhe të qetë të pronës nga Qiramarrësi.
- 7.2 Nuk do të bëjë asnjë ndryshim apo ndërtim, vetë ose nga të tretët, në dhe brenda pronës që mund të pengojë, frenojë, vështirësojë, apo ndikojë sadopak në aktivitetin e Qiramarrësit. Në rast të ndërtimeve apo ndryshimeve, Qiradhënësi do të lajmërojë me shkrim të paktën 3 (tre) muaj përpara dhe duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim të Qiramarrësit para se të procedojë me ndërtime, punime apo ndryshime.
- 7.3 Nuk do të ndërhyjë dhe nuk do të përzihet në Aparatin Marrës-Dhënës GSM/UMTS dhe pjesët e tyre, pajisjet dhe sistemin e Qiramarrësit.
- 7.4 Do të lejojë vendosjen e skarave metalike, kabllave tokëzues në fasadën e ndërtesës, në tarracë apo në kolonat vertikale dhe ndonjë pajisje tjetër brenda pronës, të cilat janë të nevojshme si pjesë e Aparatit Marrës-Dhënës GSM/UMTS, pjesëve të tyre dhe pajisjeve GSM/UMTS.
- 7.5 Do të lejojë Qiramarrësin të përdorë energjinë elektrike derisa Qiramarrësi të ketë burimin e tij të energjisë dhe sahatin matës dhe do të lejojë Qiramarrësin që të vendosë burime energjie në pronë.
- 7.6 Do të sigurojë hyrjen e lirë të Qiramarrësit, të punonjësve të tij dhe personave të autorizuar nga Qiramarrësi së bashku me mjetet dhe pajisjet përkatëse të punës në Pronë.
- 7.7 Do të sigurojë se nuk do t'i japë të njëjtat të drejta njëjloji si Qiramarrësi të cilat janë përshkruar në këtë kontratë si edhe për këtë pronë, konkurrenteve të Qiramarrësit pa miratimin paraprak me shkrim të Qiramarrësit.
- 7.8 Në rast se ndonjë ligj në fuqi kërkon aplikimin personal të Qiradhënësit si pronar i Pronës, ai do të aplikojë dhe do të mbështesë Qiramarrësin.
- 7.9 Në rast se Qiradhënësi është në dijeni të veprave apo veprimeve të të tretëve që pengojnë, vështirësojnë, apo dëmtojnë pajisjet e instaluar të Qiramarrësit, atëherë ai do të lajmërojë Qiramarrësin sa më shpejt të jetë e mundur.
- 7.10 Qiradhënësi i siguron qiramarrësit të drejtën e kalimit në prona të tjera të tij, kufi me pronën objekt të kontratës së qerasë me qëllim përmbushjen e të gjitha veprimeve të parashikuara në nenin 1 të kësaj kontrate.





7.11 Qiradhënësi i siguron qiramarrësit te drejtën e vendosjes se shtyllave te tensionit ne prone ose ne prona te tjera kufi me pronën objekt i kontratës me qellim përmbushjen e të gjitha veprimeve të parashikuara në nenin 1 të kësaj kontrate

#### Neni 8

##### Te drejta dhe detyrimet e Qiramarrësit

##### Qiramarrësi:

- 8.1 Do te përdorë pronën vetëm për qëllimet e parashikuara ne kontrate
- 8.2 Mund te beje ndërtime ose ndryshime ne prone për arritjen e qëllimeve te kësaj kontrate, gjithmone pasi ka marre aprovimin paraprak te Qiradhenesit.
- 8.3 Do ta mbaje pronën ne kushte te mira dhe do te beje përpjekjet e tij me te mira për te mos e dëmtuar.
- 8.4 Për shkak te arsyeve teknike dhe/ose azhurnimit te nevojave teknike, Qiramarrësi ka te drejte te beje ndryshime, restaurime apo shtesa, ne prone, te cilat përfshijnë por nuk kufizohen vetëm te pajisjet shtese te Radio Link, Seti i gjeneratorit, sisteme, etj, te cilat do te jene brenda kufijve te pronës dhe qëllimit te kësaj kontrate duke mos paguar asnjë qira shtese te Qiradhënësi.
- 8.5 Do te jete përgjegjës vetëm për ato dëme qe janë shkaktuar për shkak te instalimit dhe mirëmbajtjes te Aparatit Marres-Dhënës GSM/UMTS dhe pjesëve te tij.

#### Neni 9

##### Kalimi i kontratës

Asnjë nga palët nuk do ta kaloje apo transferoje me asnjë forme këtë Kontrate apo ndonjë nga te drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj, tek një person apo entitet tjetër, pjesërisht apo te teren, pa miratimin paraprak me shkrim te palës tjetër.

#### Neni 10


##### Përfundimi i kontratës nga Qiradhënësi

Qiradhënësi ka te drejte te përfundojë këtë kontrate para datës se përfundimit vetëm ne rast se: Qiramarrësi nuk ka bere pagesën brenda 2 (dy) muajve duke filluar nga data e fundit qe duhej bere pagesa ashtu si parashikohet ne nenin 6 (gjashte) te kësaj kontrate.

#### Neni 11

##### Përfundimi i kontratës nga Qiramarrësi

1. Qiramarrësi ka te drejte te përfundojë këtë kontrate përpara datës se përfundimit ne rast se:
  - Qiradhënësi nuk mund te siguroje/garantoje gëzimin e lire dhe te qete te pronës nga Qiramarrësi.
  - Qiramarrësi nuk merr dot leje, miratimi, aprovim nga pushteti dhe /ose agjencitë lokale dhe nuk nënshkruan ndonjë nga dokumentet ne lidhje me këtë kontrate.
  - Qiramarrësi është i detyruar te largohet nga territori i Republikës se Shqipërisë për shkak te luftës, trazirave apo ndonjë arsyeje te tille.
  - Një përfundim i tille i kontratës është i nevojshëm për performacen e aktivitetit te tij.
2. Qiramarrësi ka te drejte te përfundojë këtë kontrate ne çdo kohe duke bere një njoftim paraprak me shkrim prej 30(tridhjete) ditësh.
3. Ne rast te përfundimit te kontratës nga çdonjëri prej Palëve, Qiramarrësi do te çmontoje dhe heqë pajisjet e tij brenda 30(tridhjete) ditësh dhe Qiradhënësi nuk do ta pengoje apo vështirësoje Qiramarrësin ne asnjë forme dhe me asnjë mjet.



Neni 12  
Ndryshimet

Ndryshimet ne kushtet dhe termat e Kontratës mund te bëhen vetëm me marrëveshje me shkrim të palëve. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate është i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar rregullisht nga të dyja palët dhe vetëm pas nënshkrimit nga palët konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj Kontrate. Te gjitha ndryshimet inkorporohen ne Kontrate me marrëveshje formale te shkruar.

Neni 13  
Tërësia e kontratës

Kontrata se bashku me te gjitha termat dhe kushtet e saj do te interpretohet si një e tere. Ne rast te dykuptimësisë, paqartësisë apo mospërputhjeve, për shkak te ndonjë neni, paragrafi apo fraze, do te interpretohet dhe konsiderohet ne kontekstin e te gjithë Kontratës dhe sipas qëllimit për te cilin palët kane lidhur këtë Kontrate.

Neni 14  
Gjuha e kontratës

Kjo Kontrate u hartua ne 19 nene, ne 4 (katër) origjinale te përpiluara ne gjuhen Shqipe, dhe do te interpretohet ne gjuhen Shqipe.

Neni 15  
Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim qe lind si nevojë e zbatimit te kësaj Marrëveshjeje, do te dërgohet nga njëra Pale me poste te regjistruar tek Pala tjetër, sipas adresave te Palëve te përcaktuara ne këtë Kontrate:

*Për Qiradhënësin: Zef Hila*  
*Adresa: Bushat*  
*Nr. Cel. 069 20 68 177*


*Për Qiramarrësin: Gentian Hasibra*  
*Adresa: Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Tirane*  
*Nr. Cel. 069 40 61 351*

Neni 16  
Konfidencialiteti

Palët do te mbajnë konfidenciale Kontratën dhe përmbajtjen e saj. Përjashtohet nga ky rregull vetëm kur Kontrata dhe përmbajtja e saj kërkohet detyrimisht me ligj t'u behet e njohur organeve kompetente shtetërore.

Neni 17  
Ligji i zbatueshëm

Kontrata, lidhja, nënshkrimi, zbatimi dhe interpretimi, si dhe marrëdhëniet midis palëve, rregullohen sipas ligjeve Shqiptare. Te gjitha kushtet e tjera qe nuk trajtohen ne këtë Kontrate janë te zbatueshme për palët sipas akteve ligjore dhe nënligjore ne fuqi.



Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 1 Palët do të bëjnë përpjekjet maksimale që të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo Kontrate, zbatimimi dhe interpretimi i saj, të zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, për të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin apo janë në lidhje me këtë Kontrate, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 2 Nëse palët bien dakord, me dëshirën e tyre mund t'i drejtohen Arbitrazhit.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, pas se cilës Qiramarrësi mund të fillojë instalimin e pajisjeve, kurse pagesat do të bëhen në përputhje me nenin 6 (gjashtë) të kësaj Kontrate. Kontrata nënshkruhet rregullisht nga Palët në 4 (katër) kopje origjinale, në gjuhën Shqipe.

P A L E T

Për dhe në emër të Qiradhënësit  
KRYETARI I KOMUNES BUSHAT

ZEF HILA

  
  
*Zef Hila*  
*Zef*

Për dhe në emër të Qiramarrësit  
Përfaqësues me prokurë

GENTIAN HASIBRA

*Gentian Hasibra*  
